

TLAS



SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 3 / 2012



Botimi i këtij materiali është mbështetur
financiarisht nga UNICEF

unicef

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në bashkëpunim me Qendrën Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) dhe me mbështetjen e UNICEF organizoi më 05.12.2012 në mjediset e Hotel Tiranës, tryezen e rrumbullaket me teme:

“MBI RAPORTIMIN E LINDJEVE TE FEMIJEVE DHE PERMIRESIMIN E SISTEMIT TE REGJISTRIMIT”

Qëllimi i tryezes ishte të ndaje informacionin dhe ekspertizën e duhur për të bashkëpunuar dhe koordinuar me mirë punën e sektoreve dhe aktoreve të interesuar për permiresimin e metejshëm të sistemit të raportimit të lindjeve në Republikën e Shqipërisë dhe të regjistrimit të tyre. Është fakt që mbas permiresimit të legjisllacionit të Gjendjes Civile në vitin 2008 e në vazhdim, problemi i regjistrimit dhe raportimit të lindjeve në Shqipëri ka patur një progres të ndjeshëm, por ende praktika evidenton disa mangësi e pengesa që duhet të diskutohen e permiresohen. Tryeza

synon të dalë me rekomandimet perkatëse që do të sugjerohen nga ekspertet pjesëmarrës. Në tryeze morën pjesë Zv. Ministri i Brendshëm Z. Ferdinand PONI, Zv. Ministri i Shëndetësisë, Z. Alfred GAJO, Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, Z. Armand TELITI, Perfaqësuesi i UNICEF Shqipëri, Z. Detlef PALM, Drejtori Ekzekutiv i VODAFONE dhe perfaqësues të tjerë që punojnë në drejtoritë e informatikës dhe të statistikës të MB, MSH, MPCSSHB të INSTAT, etj.



1. Situata e regjistrimit të lindjeve ne Shqiperi gjate vitit 2012

Pengesa ligjore per regjistrimin e femijeve te paregjistruar nuk ka. Sipas parashikimeve ligjore dhe nenligjore çdo rast rregjistrimi te femijeve mund te realizohet drejteperdrejt ne rruge administrative.

Por, megjithate ka raste të pakta, ku rregjistrimi i lindjes se femijes mund te realizohet vetem nepermjet rruges gjyqesore. Edhe për kete fushe TLAS ka dhene kontribut nepermjet

trajnitimit te gjithë punonjesve të gjendjes civile ne mbare vendin per zbatimin korrekt te ligjit dhe akteve nenligjore te nxjerra per regjistrimin e femijeve.

Bazuar ne të dhenat e Sherbimit Ligjor Falas, TLAS, qe ka punuar ne Elbasan, Fier, Tirane dhe Durres gjate vitit 2012 jane asistuar, 282 raste regjistrime lindjesh ne zyrat e gjendjes civile, nga te cilat 60 % e tyre jane te komunitetit Rom. Femijet jane te moshave nga 1-18 vjec, 109 prej tyre jane femije qe kane lindur jasht Shqiperise dhe vetem 26 raste po ndiqen me rruge gjyqesore. Kuptohet qe te gjitha rastet e mbartuara deri tani te femijeve te paregjistruar kane te gjitha mundesite dhe mekanizmat ligjore per t'u regjistruar. Pjesa me e madhe e tyre kane nevojë per asistencë si ne plotesimin e dokumentave ashtu edhe per shpenzime financiare kur ato jane te paperballueshme nga individet vulnerabel.

Nisur nga analiza e rasteve qe kane mbetur pa regjistruar, re-



zulton se një pjesë e tyre është krijuar si pasoje e mosplotësimit sakte të certifikates “asistence në lindje” dhe e mosdeklarimit të lindjes brenda

një periudhë të caktuar. Kjo ishte dhe arsyeja e mbajtjes së kesaj tryeze, nga e cila u shtruan dhe ceshtje konkrete.

2. Ceshtjet që u shtruan për diskutim në tryeze:

Si mund të kontrollohet me mirë ceshtja e regjistrimit të të porsalindurve në mënyrë që të evitohet në maksimum mos regjistrimi i tyre, ?

Kush janë problemet që diktojnë nevojën e përmirësimit të sistemit të raportimit për regjistrimin e fëmijëve?

3. Problemet që diktojnë nevojën e përmirësimit të sistemit të raportimit në regjistrim

Ka mosperputhje të shifrave të porsalindurve që paisen me certifikata të asistencës në lind-

je nga institucionet shëndetësore të lindjes (maternitetet e rrethëve dhe shtëpive të lindjes në fshata) dhe shifrave të të porsalindurve që regjistrohen në zyrat e gjendjes civile. Që do të thotë se numri i raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zyres së Gjendjes Civile (që është i njëjti me atë të deklaruar nga INSTAT) është më i vogël se sa në raportuar nga drejtoria e Statistikës në Ministrinë e Shëndetësisë e cila i merr të dhënat nga maternitetet apo qendrat shëndetësore. Por duke e di-



tur qe ne zyrat e gjendjes civile regjistrohen edhe femije te lindur jasht shtetit apo jasht institucioneve dalim ne konkluzionin se difference eshte edhe me e madhe nga nje zbritje arithmetike e thejesht gje qe do te thote se duhet analizuar.

Edhe pse Formulari i Certifikates se Asistences ne Lindje, eshte ndryshuar me nje Udhezim te dates 7, Dhjetor 2011 nga Ministri i Shendetesise, plotesimi i tij vazhdon te behet me pasaktesi nga disa maternitete dhe qendra shendetesore, gje qe pengon regjistrimin e te porsalindurit

ne zyren e gjendjes civile sepse nuk perkon identiteti i nenes ne regjistrin themeltar me ate te shenuar ne certifikaten e asistences se lindjes. Qe me 7 Dhjetor, 2011 ne kete formular i njetje me ate ekzisues jane shtuar dy te dhena te domosdoshme qe saktesojne identitetin nenes per te shmanguar pasaktesite e hasura qe si pasoje pengojne zbatimin e ligjit te gjendjes civile.

Punonjesit e statistikave te strukturave shendetsore ende nuk e njohin udhezimin e Ministrit te Shendetesise te dates 7 Dhjetor 2011. Punonjesit e maternitetve dhe te qendrave shendetesore kane nevojte te trajnohen per te kuptuar rendesine e plotesimit me korrektese te rubrikave te Cerifikates se Asistences ne lindje, per te njohur pasojat qe shkaktojne ne rastin e mosplo-tesimit korrekt duke mos i dhene mundesine nje te porsalinduri te kete identitetin e tij.

Ministria e Shendetesise edhe pse ne baze te ligjit per gjendjen civile thuhet "Të gjitha sub-



jektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që çdo ditë të hënë të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre dhe shkëlja ose moszbatimi i dispozites se mesiperme dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë”, nuk e zbaton kete menyre raportimi.



Nje nga arsyet e mungesës së rregjistrimit të fëmijëve eshte edhe kushtëzimi i rregjistrimit te lindjes vetem me qëndrimin aktiv të nënës ose personave që vetëkonsiderohen “familjarë” dhe mos aplikimi njekohesisht i njoftimit te lindjes edhe nga subjektet shendetesore te lindjes se Ministrise se Shendetesise, pra mosfunktionimi i bashkeveprimit institucional MSH & MB. Pavaresisht arritjeve, ende konstatohet veshtiresi ne aktivitetin e aktorëve shteterore dhe jo shteterore per evidentimin dhe rregjistrimin e femijeve qe mbahen pa dokument ligjor nga persona te ndry-

shem per te realizuar rregjistrimin e tyre proceduren e ligjore te “femijeve te gjetur”.

Mungesa e informatizimit ne sektorin e linjës se institucioneve te lindjes ndikon ne cilesine e raportimit ne kohe si per lindjet ashtu edhe per vdekshmerine foshnjore

4. Rekomandime:

- Rritje e ndergjegjesimit ne nivelet politikberese dhe ato zbatuese per rendesine e proçesit.
- Trajnimi i Punonjesve te sektorit te shendetsise dhe statistiakve,



njohja me kërkesat e ligjit për gjendjen civile.

- Informatizimi i sistemit të strukturave shëndetësore nëpërmjet marrjes, regjistrimit dhe raportimit të të dhënave që në burim në momentin e lindjes apo të vdekjes, kriter baze për plotësimin e parimit të Teknologjisë së Informacionit.

- Krijimi i një Linku MSH-GJENDJA CIVILE- INSTAT për një informacion sa më të saktë të lindjeve (por edhe të vdekshmërisë foshnjore, një tregues tjetër i rendesishëm për cenimin e të drejtave

te fëmijëve dhe që ka problem si në regjistrim ashtu edhe në raportim). Ky ndërveprim do të eliminojë diferencat e pa arsyetueshme nga këto burime, do të ndikojë në mënyrë të vecantë në regjistrimin e fëmijëve, do të nxisë si strukturat përgjegjëse ashtu edhe prinderit apo të afërmit e fëmijëve.

- Është e nevojshme të krijohet një grup i përbashkët ndërmëisor për të përgatitur akte të përbashkëta apo udhëzime për të mundësuar efektivitetin e regjistrimit dhe raportimit.

- Duhet parë e studjuar praktikat më të përparuara të regjistrimit, organizmit dhe menaxhimit të një sistemi raportimi më efektiv apo të mundësise së njoftimit të çdo lindjeje drejtpërdrejt në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

- Mund të shihet nevoja për rregullime dhe përmirësime të nevojshme ligjore apo nënligjore për të lehtësuar procesin që duhet të kryejë një nënë në

rastet e kërkeses për provueshmëri të lindjes nëpërmjet analizave mjekësore me kosto të lartë dhe në rastet e mungesës së dokumentave apo dokumentave të paplota.

- TLAS mbi bazën e këtyre rekomandimeve të përgatiti një projekt propozim në bashkëpunim dhe konsulence me ekspertët e MSH dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, i cili të synojë realizimin e rekomandimeve të mesipërme.

Raimonda BOZO
Drejtoreshë Ekzekutive e TLAS



SHPALLJA E PERSONAVE TË ZHDUKUR DHE TË VDEKUR

Procedurat administrative dhe shqyrtimi gjyqësor

Një problematikë e hasur këto vite në Shqipëri është ekzistenca e personave të regjistruar në Regjistrat e Gjendjes Civile të cilët në fakt janë të vdekur. Në praktikë kjo situatë ka ardhur si pasojë e mosdijësisë së personave që në bazë të ligjit janë të detyruar të kryejnë deklarinë e vdekjes së personit të afërt. Kjo procedurë kryhet sipas ligjit Për Gjendjen Civile si më poshtë:

Deklarimi i vdekjes bëhet nga çdo pjesëtar madhor i familjes ose nga personat më të afërt të familjes dhe, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë/komunës, në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi ka vendba-

nimin/vendqëndrimin ose ku është gjetur kufoma. Deklarimet janë të vlefshme, kur shoqërohen me raport mjekësor. Deklarimi i vdekjes bëhet brenda 10 ditëve nga ndodhja ose gjetja e kufomës dhe brenda 60 ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit.

Për sa del nga kjo dispozitë ligjore, kuptojmë që ligji kërkon në mënyrë eksplicite që deklarimi i vdekjes duhet shoqëruar me raport mjekësor. Mungesa e raportit mjekësor passjell mos bërjen e mundur të regjistrimit të vdekjes. Kjo ka qenë dhe arsye-

ja për të cilën një numër i konsiderueshëm personash vazhdojnë të jenë të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile pavarësisht se ata janë të vdekur. Kjo situatë është tipike sidomos për zonat e thella malore dhe në periudha të caktuar si pas viteve '90 apo deri në vitin '97 kur situata në vend ka paraqitur problematikë dhe kur në këto zonat ka munguar ose ka qenë praktikisht jo ekzistent shërbimi mjekësor.

Sipas Ligjit "Për Gjendjen Civile", konkretisht Nenit 53, parashikohet se Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij. Shtetasi shpallet i vdekur edhe për rastet kur personi dhe organi i interesuar bëjnë vërtetimin faktik, në rrugë gjyqësore, sipas Kodit Civil. Nga kjo dispozite del qartë referimi që ligji i bën zbatimin të dispozitave të Kodit Civil për të bërë të mundur vërtetimin e vdekjes në rrugë gjyqësore në rastet kur mungojnë dokumentacioni që ligji përcakton për



të bërë të mundur regjistrimin e vdekjes në rrugë administrative.

Sipas Kodit Civil, konkretisht Nenit 19 përcaktohet se “Personi që ka humbur gjatë një fatkeqësie natyrore **ose në rrethana që bëjnë të besohet se ka vdekur**, mund të shpallet si i tillë me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme dy vjet nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojshme të shpallet më parë i zhdukur. Kur nuk caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati dy vjeçar fillon nga dita e parë e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia dhe, kur nuk mund të caktohet as muaji, afati fillon nga dita e parë e muajit janar të vitit të mëpasëm. Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë. Vendimi i gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.



Sipas Kodit të Procedurës Civile, ky process hyn në ato që quhen gjykime të posaçme dhe proceduralisht gjykohen sipas përcaktimeve që bën ky kod në nenet 375 e vijues të tij.

Sipas Kodit të Procedurës Civile “Kërkesa për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur mund të paraqitet nga çdo person i interesuar dhe nga prokurori në gjykatën ku ka pasur vendbanimin e fundit personi për të cilin kërkohet shpallja si i tillë.

Në kërkesën për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur, përveç rrethanave nëpërmjet të cilave bëhet e besueshme zhdukja ose vdekja e tij, tregohet edhe kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i tij, për rastet kur ka të tillë. Në kërkesën për deklarimin e një personi si të vdekur, duhet të tregohen edhe personat që janë ose mund të jenë trashëgimtarë të tij, si dhe gjithë personat e tjerë për të cilët është e ditur që nga ky fakt fitojnë ose humbin të drejta. Gjykata, brenda dhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesës për

gjykim, i dërgon një kopje të saj bashkisë ose komunës, ku ka pasur banimin e tij të fundit personi që kërkohet të shpallet i zhdukur ose i vdekur, për ta shpallur në një vend të dukshëm. Kërkesa e mësipërme botohet edhe në Fletoren Zyrtare, si dhe të paktën në një gazetë lokale. Shqyrtimi i çështjes nga gjykata nuk mund të bëhet pa kaluar gjashtë muaj nga shpallja e kërkesës ose botimit të saj në Fletoren Zyrtare.

Gjykata, në shqyrtimin e kërkesës për shpalljen të zhdukur ose të vdekur të një personi, pyet njerëz të afërt të tij, merr të dhëna për këtë person nga bashkia ose komuna, ku ai ka pasur vendbanimin e tij të fundit, si dhe nga çdo burim tjetër që mund të japë lajme për këtë person.

Gjykata vendos për shpalljen e një personi të zhdukur apo të vdekur, pasi të ketë dëgjuar edhe personat që përmenden në nenin 375 e 376 të Kodit civil që janë personat e interesuar apo trashëgimtarët ligjorë të personit të vdekur, si dhe prokurorin. Gjykata urdhëron botimin



e shkurtimit të vendimit në Fletoren Zyrtare ose të paktën në një gazetë lokale të caktuar prej saj ose në një mënyrë tjetër publikimi që do ta quajë të dobishme. Gjykata mund të marrë edhe masa për sigurimin e pasurisë sipas rrethanave që e bëjnë të nevojshme marrjen e tyre. Vendimi i gjykatës, që e deklaron një person të zhdukur ose të vdekur, i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile në të cilën ai ka qenë i regjistruar, pasi të sigurohet se është bërë publikimi i tij sipas përcaktimeve të mësipërme.

Sipas Nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile, ky gjykim për shkak të karakterit të tij kompleks e të rëndësishëm hyn në ato çështje që Kodi i ka dhënë një rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye gjykimi i tyre bëhet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, dhe në gjykim merr pjesë edhe prokurori si person i tretë.

ADNAN HOXHA
Avokat, TLAS

Histori e Vërtetë

Klientët Dh.S dhe Xh.S janë gjyshërit e një fëmije të mitur i cili figuronte i paregjistruar ne Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Fëmija ishte lindur nga bashkëjetesa e djalit të kërkuesve me nënën e fëmijës. Gjatë bashkëjetesës ata kishin jetuar në shtëpinë e kërkuesve. Fëmija kishte lindur në maternitet por asnjëherë nuk ishte bërë i mundur regjistrimi i fëmijës. Menjëherë pas lindjes nusja e djalit ishte larguar nga banesa duke e braktisur fëmijën që foshnje. Që nga ajo kohe gjyshërit ishin kujdesur për fëmijën duke e rritur dhe duke u përkujdesur vazhdimisht pasi edhe djali i tyre ndodhej në emigracion. Pasi u paraqit në zyrën tonë dhe pasi u diskutua çështja nga këshilltari i projektit dhe nga të gjithë avokatët e zyrës u mendua që fillimisht të kryhej regjistrimi i fëmijës sipas Udhëzimit nr. 07 datë 10.01.2012 të Ministrit të Brendshëm.



Sipas këtij Udhëzimi në rastet kur regjistrimi i fëmijëve bëhet i pamundur për arsye se fëmija është lindur nga nëna, jashtë institucioneve shëndetësore dhe më pas është braktisur nga ajo duke ia lënë në kujdesje familjarëve të saj ose në rastet në të cilat prindërit kanë lindur fëmijë por janë larguar jashtë shtetit dhe nuk janë kthyer duke ia lënë fëmijët për kujdesje gjyshërve apo të afërmeve të tjerë, ai të mund të kryhet nëpërmjet procedurash më lehtësuese kryesisht administrative në bashkëpunim me përfaqësues të

njësive të qeverisjes vendore apo të policisë së shtetit.

Pasi u krye regjistrimi i fëmijes me prindër të panjohur lindi nevoja që gjyshja ti drejtohej Gjykatës për caktimin e saj si kujdestare ligjore e fëmijës, dhe po ashtu në zbatim të edhe të përcaktimeve që bën Udhëzimi ku sipas të cilit, në modularin 1 bashkëngjitur parashikon: “Mbas regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile sipas nenit 39 (pika 1, 2, 3, 5) të ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” dhe pajisjes së tij me certifikatë lindje, personi i interesuar duhet t’i drejtohet Gjykatës për marrjen e kujdestarisë së fëmijës ...”

Lidhur me këtë u mbledhën të gjithë dokumentat e nevojshëm për të filluar procesin gjyqësor. Pas mbledhjes së këtyre dokumentave çështja u paraqit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt Caktimin e të drejtës së ushtrimit të kujdestarisë për fëmijën e mitut Xh. Gj.

Sipas nenit 224 të kodit të Familjes “Në qoftë se prindërit

e fëmijës kanë vdekur, janë në pamundësi të ushtrojnë përgjegjësi prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës së tyre ose për arsye të tjera të rënda, fëmija mund ti besohet nje anëtar i familjes”. Në këtë rast ndodheshim përpara të njëjtin rast kur njëri nga prindërit kishte vdekur dhe prindi tjetër nuk e ushtronte efektivisht përgjegjësinë prindërore.

Sipas nenit 263 të Kodit të Familjes “Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.

Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit.”.

Sipas nenit 264 të Kodit të Familjes “të drejtën e paraqitjes së

kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë: të afërmit e fëmijës së mitur ...”.

Neni 270 i Kodit të Familjes parashikon shkaqet e papajtueshmërisë së të qenit kujdestar i cili nuk mund të jetë i tillë kur:

- a) është vetë në kujdestari;
- b) ka konflikt interesash me të miturin;
- c) nuk ka administrimin e lirë të pasurisë së tij;
- ç) është përjashtuar nga kujdestaria për shkak të deklarimit me shkrim të prindit që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore;
- d) ka humbur ose i është hequr



përgjegjësia prindërore, ose është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;

dh) është i dënuar me burgim për një vepër penale dhe është gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe kur është dënuar për krime ndaj të miturve.

e) ka mbushur moshën 65 vjeç;

ë) për shkak të gjendjes së tij shëndetësore nuk mund ta ushtrojë me lehtësi kujdestarinë;

f) ushtron përgjegjësinë prindërore në më shumë se tre fëmijë;

g) është i ngarkuar me më shumë se dy kujdestari;

gj) nuk jep pëlqimin për të qenë kujdestar.

U procedua për mbledhjen e të gjithë dokumentave të nevojshëm që do të shërbenin në këtë rast duke u marrë të gjithë dokumentat e kërkuara për të vërtetuar në rradhë të parë përmbushjen e kërkesave të mësipërme të ligjit që duhen plotësuar për të qenë kujdestar dhe po ashtu edhe dokumentat që provonin faktin që fëmija ishte nën kujdesin faktik të gjyshërve të tij dhe se nëna nuk interesohej pothuajse aspak dhe nuk kontribuonte në rritjen dhe edukimin e tij.

Ky rast përbente një rast specifik të kërkimit për caktim Kujdestari, pasi në gjykim përbente vështirësi të provuarit e lidhjes ndërmjet kërkuese dhe fëmijës i cili do të vendosej në kujdestari. U arsyetua ndërmjet të tjerash se **Sipas Nenit 264 dhe 268 të Kodit të Familjes dhe Nenit 351 të Kodit të Procedurës Civile**, parashikohet se “Kërkesa për vendosjen në kujdestari i paraqitet Gjykatës nga të afërmit e fëmijës, vetë i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, prokurori, noteri, nëpunësi i gjendjes



*civile apo cdo person që merr
dijeni për mbetjen e fëmijes pa
prindër.*

AMESIA, NJOHJA DHE KUNDERSHTIMI

Për atë që sa parashikohet më
sipër ligji parashikon paraqitjen
e kërkesës edhe nga personi i
interesuar pas pasur nevojë që
të vërtetojë një lidhje afërsie
gjinore me fëmijën por të ekzis-
tojë fakti që ky person përkujde-
set realisht për fëmijën.

Pas disa seancave gjyqësore
gjykata arriti në përfundimin se
e gjente të drejtë dhe të ba-
zuar në ligj kërkesën e bërë
nga klientja Dh.S. duke i dhënë
të drejtë për kërkimin e saj dhe
duke vendosur caktimin e saj si
kujdestare ligjore e fëmijës.

ADNAN HOXHA
Avokat, TLAS

Një nga konceptet më të
rëndësishme që është
parashikuar edhe në Kodin e
Familjes është “Amesia”. Vetë
termi amesi përfshin a) njohjen
e amesise dhe b) kundërshtimin
e amesise dhe kundërshtimin e
njohjes së amesise.

Janë pikërisht rastet e njohjes
së amesise për fëmijët të cilët
janë fryt i bashkëjetesës të cilat
hasen më shumë në praktikën
gjyqësore shqiptare.



Në këto raste ligji parashikon si procedurë faktin e paraqitjes së personit që kërkon të njihet si prind i një fëmije të lindur jashtë martese

Amësia dhe atësia e fëmijës se lindur jashtë martese mund të vendosen me ane të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe për prindërit krijon të drejta dhe detyrime të njëjta, në mënyrë prapavepruese, si për fëmijët e lindur nga martesa.

Vendimi i gjykatës që përcakton amësinë ose atësinë ka efekt që nga lindja e fëmijës.

Në çdo rast amësia e fëmijës vërtetohet me aktin e lindjes.

Gjithsesi në rastin e njohjes së amësisë ka një procedurë të caktuar si më poshtë:

Kur fëmija është regjistruar në aktin e lindjes me prindër të panjohur, nëna mund ta njohë fëmijën. Njohjen e fëmijës mund ta bëjë edhe vetë nëna e mitur. Njohja mund të bëhet para nëpunësit të gjendjes civile ose me testament. Njohja e bërë nuk mund të revokohet edhe sikur të jetë bërë me testament.

Fëmija i regjistruar në aktin e lindjes me prindër të panjohur mund të kërkojë nga gjykata vërtetimin e amësisë.

E drejta e padisë për vërtetimin e amësisë nuk u kalon trashëgimtarëve të fëmijës, por gjykimi i filluar që më parë mund të vazhdojë nga trashëgimtarët. Padia për vërtetimin e amësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të gruas që kërkohet të vërtetohet se është nëna.

E drejta e padisë për vërtetimin e amësisë nuk parashkruhet gjatë gjithë kohës që fëmija jeton.



Persa I perket kundërshtimit të amesise parashikohet kjo procedure:

Amësia e treguar në aktin e lindjes mund të kundërshtohet nga gruaja e regjistruar si nënë e fëmijës ose nga gruaja që kërkon të njihet si nënë ose nga fëmija kur behet madhor.

E drejta e padisë nuk u kalon trashëgimtarëve, por gjykimi i filluar mund të vazhdojë prej tyre. Kjo padi mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të gruas së regjistruar si nënë. E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet.

Ndërsa procesi i kundërshtimit të njohjes së amesise zhvillohet sipas procedurës së mëposhteme:

Njohja e amësisë mund të kundërshtohet në gjykatë nga gruaja që kërkon të njihet si nënë, nga fëmija kur behet madhor ose nga prokurori.

E drejta e padisë nuk u talon trashëgimtarëve, por gjykimi i filluar me pare mund të vazhdojë nga trashëgimtarët e paditësit. Kjo padi mund të ngrihet edhe

kundër trashëgimtarëve të nënës që ka njohur fëmijën.

E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet.

Vlen të theksohet fakti se ligji e lidh të drejtën e ngritjes së padisë me një afat pas të cilit nuk mund të drejtohesh gjykatës në bazë të parashikimeve të mësipërme.

Theksojmë se raste të tilla janë të rralla dhe procese mjaft delikate.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS



Histori e Vërtetë

Pranë Zyrës tonë rreth 1 vit e gjysëm më parë u paraqit një kliente me iniciale I.K, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet shoqatave të rrethit të Elbasanit ajo u paraqit duke kërkuar regjistrimin e dy femijeve të djalit të saj të lindur nga bashkejetesa me shtetasen A.A.

Gjendja e klientes I.K ishte mjaft e vështirë pasi ajo kishte edhe 2 fëmijë me bashkëshortin e saj të cilin e kishte divorcuar dhe kërkonte t'i mbante ajo edhe pse ishte

pa punë për momentin dhe në kushte shumë të keqja strehimi.

Duke parë vështirësinë e rastit të paraqitur u krye një intervistim i kujdesshem nga keshilltari i projektit për të qartësuar me shumë situatën ligjore dhe faktike të klientes I.K.

Nga intervista u konstatua se:

Klientja I.K ishte gjyshja e femijeve të cilët kishin lindur nga bashkejetesa e djalit të saj me shtetasen A.A. Perpara 4 vjetesh për shkak të një aksidenti automobilistik asaj i kishte vdekur djali duke lënë jetim dy fëmijet e mitur të cilët ishin të pargjistruar në regjistrin e gjendjes civile. Nena e femijeve shtetasja A.A në momentin që kishte vdekur i ati i femijeve ishte larguar nga banesa dhe që prej 4 vjetesh ishte larguar drejt shtetit Grek dhe nuk dihej asgjë për vendodhjen e saj.

Fëmijet gjate gjithë kësaj kohe kishin jetuar me gjyshen e tyre nga i ati klienten I.K e cila ishte kujdesur vazhdimisht për ta.

Nga intervista u konstatua se klientja I.K i plotesonte kushtet për të përfituar ndihmë ligjore nga ana e zyrës tone.

U procedua me marrjen e dokumentave të nevojshëm për fillimin



e gjyqit gje e cila mori pak kohë pasi duke marrë parasysh se klientja jetonte ne qytetin e Elbasanit. U terhoqen prane nga Materniteti i Elbasanit Certifikatat e asistences se lindjes se dy femijeve ne baze te kekreses se Avokatit te zyles proces i cili mori kohe pasi ishte shume e veshtire qe te pajiseshe me certifikatat e asistences se lindjes duke marre parasysh faktin se nuk ishte nena e pranishme. Me dokumentat e maternitetit dhe me leternjoftimin e klientes I.K u drejtuam ne zyrat e gjendjes Civile Elbasan per te bere te mundur regjistrimin e femijeve ne zyrat e gjendjes civile.

U plotesuan procesverbalet perkatese nga punonjesi i gjendjes civile si dhe nga punonjesi i policise se shtetit ne prani edhe te kerkueses I.K te cilat u firmosen per secilin nga femijet.

Mbasi mbaroi procedura e perpilimit te procesverbaleve u depozi-tuan keto dokumenta ne zyren e gjendjes civile te klientes I.K ku u be edhe regjistrimi i femijeve ne nje flete te vecante familjare.

Gjykata pas një pune te lodhshme dhe nje hetimi te hollësishëm



pikërisht për shkak të egzistencës së 2 fëmijëve të mitur arrihem ne përfundimin e kerkuar nga klientja I.K. Përsa l përket fëmijëve ata të jetojnë me gjyshen e tyre per faktin e moshës së disa prej tyre por edhe per perkujdesje më të madhe nga ana e saj nga zyra jone kane filluar procedurat gjyqesore per marrjen e kujdestarise ligjore te femijeve nga gjyshja e tyre.

Mbas një pune pothuajse 2 vjecare duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klientja I.K.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS

Histori e Vërtetë 1

Para disa muajsh u paraqit në Shërbimin Ligjor Falas Tiranë, M.T. dhe kërkoi ndihmë ligjore për të regjistruar mbesën e saj 2 vjeçare, të cilën nëna e kishte braktisur në familjen T. që është familja e babait të fëmijës. Sipas gjyshes, fëmija kishte lindur nga bashkëjetesa e shkurtër e djalit të saj I.T. dhe P.D. Çifti nuk ishte martuar, për shkak se gjatë bashkëjetesës, u konstatua që P.D. ishte me sëmundje psiqike. Në TLAS u paraqit disa herë edhe babai i fëmijës I.T. dhe u sollën një sërë

dokumentash që provonin se nëna e fëmijës ishte invalide dhe kishte sëmundje psiqike. Babai i fëmijës kërkonte të bënte regjistrimin e fëmijës, të njëjtte atësinë dhe të siguronte kujdestarinë e fëmijës, meqë nëna nuk ishte në gjendje ta mbante dhe ta rriste fëmijën, për shkak të sëmundjes së saj.

Për të sqaruar situatën, TLAS pati disa biseda me Xh.D., gjyshin e fëmijës nga nëna, babain e P.D. Në këto biseda ju bë e qartë Xh.D. që fëmijën mund ta regjistronte nëna, në bazë të çertifikatës së asistencës në lindje, të lëshuar nga materniteti dhe vetëm nëna mund ta njëjtte ose jo atësinë e fëmijës. Megjithatë Xh.D. u zotua të ndiqte procedurat e përcaktuara ligjore për raportimin e lindjes së fëmijës nga ana e nënës dhe regjistrimin e fëmijës, edhe për disa muaj të tjerë nuk u bë asgjë. Sipas familjes T., kjo bëhej për ta detyruar I.T. që të bënte martesën me P.D. dhe pastaj të regjistrohej fëmija. Ndërkohë, vajza vazhonte të qëndronte në familjen e babait, e paregjistruar.



Duke parë mungesaën e vullnetit të familjes së nënës për regjistrimin e fëmijës, TLAS, në bashkëpunim me zyrën e gjendjes civile të Njësisë Bashkiake Nr. 3, filloi procedurat e regjistrimit të fëmijës, duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm, Nr. 7, datë 10.01.2012, “Për miratimin e procedurës dhe të proces-verbaleve, që do të plotësohen nga përfaqësues të policisë së shtetit dhe të bashkive/njësisë bashkiake/komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile”, si fëmijë me prindër të panjohur. Duke patur një regjistrim fillestar të fëmijës, mund të vazhdohej më tej me ndjekjen e procedurave gjyqësore për njohjen e amësisë, atësisë apo kujdestarisë, sipas rastit.

Kur familja e nënës u vu në dijeni që kishin filluar procedurat e regjistrimit të fëmijës me prindër të panjohur, u vu në lëvizje dhe bëri regjistrimin e fëmijës, sipas ligjit, duke mos njohur atësinë e fëmijës. Regjistrimi i fëmijës ishte një veprim shumë i rëndësishëm. Më në fund, kjo vajzë e vogël ka tashmë

mundësi të identifikohet dhe të përfitojë të gjitha shërbimet dhe të drejtat që i takojnë, duke filluar që nga mundësia për të përfituar shërbim shëndetësor. Tashmë që vajza ka një identitet, familja T. po ndjek procedurat gjyqësore për njohjen e atësisë së fëmijës.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare Programi, TLAS



Histori e Vërtetë 2

N.D. është një nënë e re, që ka lindur tre fëmijë. Asnjëri prej tyre nuk është i regjistruar në gjendjen civile, sepse vetë N. nuk ishte e regjistruar në gjendjen civile. Ajo banon në një barakë në Bregun e Lumit, në Tiranë dhe nuk mund të sigurojë as vizitat e fëmijëve tek mjeku, as përfitimin nga shteti të ndonjë ndihme ekonomike. Nëna e ka lindur N. në kushte shtëpie dhe nuk ka patur asnjë dokument për këtë lindje. Nga ana tjetër, ajo e ka braktisur N. që në moshë të vogël dhe prindërit që e rritën, nuk

patën asnjë mundësi ligjore që ta regjistronin. Mbas një procedure të gjatë gjyqësore, u arrit që më në fund N.D. të regjistrohet në gjendjen civile.

Mbas regjistrimit të N.D. në gjendjen civile, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) u kujdes që ajo të aplikojë për t'u pajisur me letërnjoftim. Vetëm duke patur këtë dokument identifikimi, ajo mund të vazhdojë të realizojë regjistrimet e tjera në gjendjen civile. Procedurat e regjistrimit të N.D. dhe pajisja e saj me letërnjoftim, nuk ishte shumë e lehtë, sepse gjendja civile e saj është jashtë Tiranës dhe asaj i është dashur të udhëtojë shumë herë, gjithnjë e shoqëruar nga fëmija e saj me e vogël, disa muajshe.

N.D. dëshiron të regjistrojë tre fëmijët e saj dhe njëkohësisht të bëjë edhe martesën me babain e fëmijëve F.K., me të cilin bashkëjeton prej shumë vitesh. Por edhe F.K. nuk ishte i pajisur me letërnjoftim dhe u desh mjaft kohë, që edhe ai të mund të kishte këtë dokument identiteti. Vështirësia e tij



për t'u pajisur me këtë dokument, vinte nga fakti që ai asnjëherë nuk kishte patur ndonjë çertifikatë me fotografi, për t'u identifikuar fillimisht.

Tashmë që edhe N.D. është në pritje të marrë letërnjoftimin, TLAS ka filluar procedurat për të realizuar martesën e tyre. F.K. ka kryer hapin e parë të martesës. Ai është pajisur me një çertifikatë për shpallje martese dhe do vazhdohet edhe me marrjen e po kësaj çertifikate për N.D. nga zyra e saj e gjendjes civile.

Mbas lidhjes së martesës, do vijohet me regjistrimin e tre fëmijëve të tyre. Duhet të themi që TLAS është kujdesur që për këta fëmijë të sigurojë dublikata për çertifikatat e asistencës së tyre nga materniteti, meqë nëna e tyre, i kishte humbur çertifikatat origjinale. Martesa e N.D. me F.K. dhe regjistrimi i tre fëmijëve të tyre do të bëjë që më në fund kjo familje të jetë e regjistruar rregullisht në regjistrin e gjendjes civile. Duke u nisur nga kushtet shumë të vështira ekonomike dhe mungesa e strehimit, ata do

mund të aplikojnë në programet sociale të Bashkisë Tiranë, për të përfituar ndihmë ekonomike dhe strehim.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare Programi, TLAS



KRIMET SEKSUALE NDAJ TE MITURVE

Krimet seksuale gjenden te parashikuara ne nje seksion me vete te pjeses se posaçme te Kodit Penal, ne seksionin e VI-te te Kreut te II- te, i cili eshte kreu i veprave penale kunder personit. Objekti grupor i krimeve seksuale jane marredheniet juridike te vendosura per te siguruar lirine seksuale te te miturit.

Mbrojtja juridike penale e lirise seksuale e ka burimin tek mbrojtja kushtetuese qe i behet lirise

se personit. Vlen te vihet ne dukje se ne parashikmin e krimeve seksuale eshte marre parasysh mbrojtja e vecante kushtetuese dhe nderkombetare qe i behet femijeve. Ajo qe deklarohet ne mjaft akte nderkombetare, sic eshte Konventa mbi te drejttat e femijes, dhe qe ka gjetur pasqyrim edhe ne Kushtetute ne Nenin 54/1 te saj, ku, krahas te tjerave, thuhet se femijet kane te drejten e nje mbrojtje te vecante nga shteti, gjejne misherim, nder te tjera, edhe ne mbrojtjen juridike penale qe i behet lirise dhe zhvillimit seksual te te miturve ne Kodin Penal aktual. Keshtu ne kete te fundit realizohet nje mbrojtje e diferencuar e te miturve nen 14 vjec dhe atyre nga 14 gjer ne 18 vjec.

Neni 100

Marredhenie seksuale ose homoseksuale me te mitur

Kryerja e maredhenieve seksuale ose homoseksuale me femije te mitur, qe nuk ka arritur moshen 14 vjec ose me te mituren qe nuk ka arritur pjekurine seksuale, denohet



me burgim nga shtate deri ne pesmbedhjet vjet.

Kur maredhenia seksuale ose homoseksuale kryhet ne bashkepunim, me shume se nje here, ose me dhune, ose kur i jane shkakuar femijes se demtuar pasoja te renda pershendetin, denohet me burgim nga pesmbedhjet gjer ne njezet e pese vjet.

Kur vepra ka sjelle si pasoje vdekjen ose vetevrasjen e femijes se mitur denohet me burgim jo me pak se njezet vjet.

Kjo dispozite merr ne mbrojtje te vecante paprekshmerine (lirine) seksuale, per hir te zhvillimit normal seksual, shendetesor e mendor, te te miturve nen 14-vjec dhe te atyre qe, ndonese kane arritur kete moshe, nuk kane arritur pjekurine seksuale. Presupozohet se i mituri nen 14-vjec, jo vetem nuk e ka arritur pjekurine seksuale, por nuk ka arritur as aftesine mendore per te kuptuar plotesisht karakterin e vepres dhe te pasojave. Kjo do te thote qe edhe nese maredhenia seksuale kryhet me pelqimin e se miturit, ajo do te formoje figuren e

vepres penale, pasi prezumohet se i mituri nen 14-vjec nuk mund te shprehe nje vullnet te vlefshem. E njehta gje mund te thuhet edhe per te miturit qe, ndonese e kane arritur kete moshe, nuk kane arritur pjekurine seksuale pasi kjo e fundit ka lidhje me zhvillimin e pergjithshem fizik e mendor te tij. Pra dispozita ka per qellim, ne teresine e saj, mbrojtjen e integritetit fizik dhe mendor te te miturit nen 14-vjec dhe atij qe e ka arritur kete moshe, por pa arritur pjekurine seksuale. Kjo mbrojtje eshte realizuar nepermjet perdorimit te dy kriterave alternative, kriterit moshe, nga njera ane, dhe atij te arritjes se





pjekurise seksuale, nga ana tjetër. Me pjekuri seksuale kuptohet arritja e aftësisë së plotë për të kryer funksionet seksuale pa pasoja të demshme për shëndetin. Në këtë kontekst, aftësia për të mbetur shtatzanë të vajzave është një element i rëndësishëm që provon arritjen e pjekurisë seksuale. Verifikimi i arritjes së pjekurisë seksuale është objekt i ekspertimit mjekoligjor.

Kur flasim për kryerje të marrëdhënieve seksuale nenkuptojmë bashkimin seksual, pasi nëse nuk ndodh ky ifundit, përkryhen vetëm vepra të turpshme, atëherë ndry-

shon çështimi juridik i veprës (i cili në këtë rast do të bëhet në bazë të nenit 108, i cili parashikon veprat e turpshme).

Gjatë gjykimit të këtyre veprave, është vërejtur se të pandehurit e akuzuar për këto vepra penale kanë invokuar në mbrojtje të tyre padijeninë rreth moshës së të demtueses, duke pretenduar se padijenja e tyre ishte objektive, për shkak të zhvillimit jo të zakonshëm fizik të të demtueses. Në këtë pikë vlen të përmendet qëndrimi që mban legjislatori italian, i cili, duke e trajtuar si përjashtim nga parimi i përgjithshëm, nuk lejon që padijenja rreth moshës së të miturës të përbejë shkak për përjashtimin nga përgjegjësia penale. Në këtë qëndrim legjislatori italian udhëhiqet nga nevojat për të penguar çdo shmangie nga ndeshkimi për fakte që ndergjegjia njerezore i konsideron shumë të rënda. Duke shtuar se padijenja në pjesën më të madhe të rastëve përben një shkak që përdoret në mënyrë spekulative, për fitimshmësi përgjegjësive penale, mendojmë se të njëjtin qëndrim duhet të adaptojnë edhe gjykatat shqiptare.

Ne paragrafin e pare te nenit 100 parashikohet pergjegjesia penale per personin qe kryen marrëdhënie seksuale me te mituren qe ka arritur moshen 14-vjec, por qe nuk ka arritur pjekurine seksuale. Si pas shkences mjekesore, pjekuria seksuale arrihet, si rregull, rreth moshes 14-15 vjec per vajzat dhe 16-17 vjec per djemte. Ne kete kontekst, momenti kohor i arrijtes se pjekurise seksuale ka lidhje me moshen ligjore per te lidhur martesë. Me lejimin e martesës ne nje moshe te caktuar ligji pranon se ne kete moshe eshte arritur pjekuria seksuale. Keshtu, lgjislacioni yne familjar sanksionon si kusht per lidhjen e martesës moshen 18-vjec, per vajzat dhe per djemte. Ne vazhdim te kesaj ideje, veprimi i normes penale ne fjale shtrihet, praktikisht, ndaj rasteve kur i mituri qe ka arritur moshen 14-vjec, por jo pjekurine seksuale. Ketu vlejne te gjitha sa u thane per krimin e marrëdhënieve seksuale me te mitura qe nuk kane arritur moshen 14-vjec.

Ne paragrafin e dyte te nenit 100 parashikohen si rethana cilesuese



perdorimi i dhunes dhe ardhja e pasojave te renda per shendetin e te demtuarit. Ne kuptimin e dhunes futet dhuna fizike dhe ajo psikike. Me dhune fizike duhet te kuptohet cdo investim i forces fizike qe mund te shprehet ne rrahje, goditje, plagosje e lehte, kapje prej flokesh, lidhje e te demtuarit, etj. Nese ndaj te demtuarit ushtrohet dhune fizike ai eshte i privuar krejtesisht nga mundesia per te shfaqur vullnet dhe sjellja e tij nuk eshte e tija, por e vepruesit. Pra, dhuna fizike perben nje shterngim absolut, ndryshe nga dhuna psikike, e cila konsiston ne nje shterngim relativ.

Me dhune psikike duhet te kuptohet cdo veprim mbi psikiken e te demtuarit qe nuk e privon ate krejtesisht nga mundesia per te shfaqur vullnet, por e kufizon kete te fundit ne menyre te konsiderueshme. Ndryshe nga dhuna fizike, gjate ushtrimit te se ciles i demtuari nuk shfaq vullnet, dhuna psikike e lejon te demtuarin te shfaq vullnet, por ky vullnet eshte i vesuar, pasi nuk eshte shfaqur ne menyre krejt te lire. Megjithate, edhe ne rastin e dhunes psikike mund te ndodhe qe i demtuari te jete i privuar nga mundesia per

te shfaqur vullnet, sic eshte rasti kur ajo kanoset me arme. Nese dhuna fizike eshte nje e keqe aktuale, dhuna psikike konsiston ne kercenimin per shkaktimin e nje te keqeje ne te ardhmen, ndonese edhe ne kete rast te fundit nuk perjashtohet mundesia qe e keqja te jete aktuale, sic eshte, p.sh, rasti i turbullimit psikik qe peson personi ndaj te cilit ushtrohet dhuna psikike.

Dhuna psikike nuk konsiston vetem ne kanosjen per kryerjen e nje krimi, sic mund te jete vrasja ose plagosje a e rende, por edhe per kryerjen e veprimeve qe nuk perbejne krim, por cenojne nje person, sic mund te jete perhapja e informatave te verteta qe diskreditojne te demtuarin, kallezimi i nje vepre penale te kryer prej tij, etj. Gjithashtu, e keqja qe permban dhuna psikike mund t'i adresohet vete te demtuarit (p.sh. kanosja per plagosje te rende), nje personi te trete qe ka nje lidhje te caktuar (dashurie, miqesie, solidariteti, etj) me te demtuarin (p.sh. subjekti kercenon te demtuaren se do t'i perdhunoje te motren e vogel qe ndodhet aty) ose nje te mire materiale



(p.sh subjekti kercenon te demtuarin se do t'i shkaterroje nje send shume te cmuar qe ajo mban me vete). Ne kete rast te fundit dhuna fizike mbi sendet perceptohet nga i demtuari si dhune psikike. Kur flasim per dhune fizike mbi sendet kemi parasysh se ato mund te demtohen, transformohen, nderrojne destinacion, shkaterrohen, etj. Pra, dhuna psikike nuk eshte e thene qe te jete e lidhur vetem me jeten apo integritetin fizik, por edhe me lirine, moralin e personit, te mirat pasurore, etj.

Krimi i marredhenieve seksuale me dhune ekziston pavaresisht nga fakti nese i demtuari edhe me pare mund te kete kryer marredhenie seksuale me subjektin e krimit ose me nje tjeter, mjafton qe per kryerjen e krimit te jete perdorur dhuna fizike ose psikike. Perdorimi i dhunes mund te vertetohet nepermjet ekspertimit mjeko-ligjor.

Eshte e kuptueshme qe duhet medoemos qe te provohet lidhja shkakesore ndermjet aktit te marredhenies seksuale dhe pasojes se rende qe ka ardhur. Ne paragrafin e trete te nenit 100 parashikohet nje rrethane tjeter



e cilesuar, vdekja ose vetevrasja e te miturit, e cila shoqerohet me nje ashpersim te denimit. Vdekja e te miturit mund te kete ardhur, p.sh, nga nje hemoragji e madhe, ndersa vetevrasja mund te jete nje akt te cilin i mituri e ka kryer ne nje gjendje deshperimi te thelle, te shkaktuar nga pesimi jashte vullnetit te saj te marredhenies seksuale. Edhe ne kete rast eshte esenciale te provohet ekzistenca e lidhjes shkakesore, d.m.th. qe vdekja apo vetevrasja te jene pasoje e drejteperdrejte e veprimit kriminal.



Neni 101

Maredhenie seksuale ose homoseksuale me dhune me te mitur te moshes 14-18 vjec

Kryerja e Marredhenieve seksuale ose homoseksuale, me dhune, me femije te mitur ne moshen katërmbëdhjetë vjetër që ka arritur pjekurine seksuale, denohet me burgim nga pesë vjetër deri në pesëmbëdhjetë vjetër.

Kur maredhenia seksuale ose homoseksuale, me dhune, kryhet në bashkëpunim ose me shume se

një herë, ose kur femijes së demtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, denohet me burgim nga dhjetë vjetër deri në njëzet vjetër. Kur vepra ka sjelle si pasoje vdekjen ose vetëvrasjen e femijes së mitur denohet me burgim jo më pak se njëzet vjetër.

Që të linde përgjegjësia penale në baze të kesaj dispozite duhet të konkurojnë njëkohësisht tre kushte: 1) i mituri të jetë i moshës nga 14-18 vjetër; 2) të ketë arritur pjekurine seksuale; 3) kryerja e marrëdhënies seksuale të jetë diktuar nga përdorimi i dhunës. Nëse për të miturit nën 14 vjetër dhe ato që kanë arritur këtë moshë, por pa arritur pjekurine seksuale, përdorimi i dhunës është rrethane çilesuese, për të miturat nga 14-18 vjetër, të cilat e kanë arritur pjekurine seksuale, dhuna është element përberës i figurës së veprës penale dhe pa dhunë nuk ka krim.

Është e rëndësishme të theksohet se arritja e pjekurisë seksuale është një kusht i rëndësishëm, pasi në qoftë se i mituri 14-18 vjetër nuk e ka arritur pjekurine seksuale, atëherë çilesimi juridik nuk do të bëhet në baze të kesaj

dispozite, por ne baze te nenit 100 (permendur me siper).

Neni 106

Maredhenie seksuale ose homoseksuale me persona ne gjini ose nen kujdestari

Kryerja e maredhenieve seksuale ose homoseksuale ndermjet prindit dhe femijes, vellait dhe motres, ndermjet vellezerve, motrave, ndermjet personave te tjere qe jane ne gjini ne vije te drejteose me persona qendodhen ne raporte kujdestarie ose te biresimit, denohet me burgim gjer ne shtate vjet.

Ne kete vetep penale rrethi i subjekteve eshte i percaktuar ne menyre taksative. Keshtu behete fjale per maredhenie seksuale ndermjet: atit dhe bijes; djalit dhe nenes; gjyshit dhe mbeses; gjyshes dhe nipit; vellait dhe motres, qofte edhe prej nene ose babai; kujdestarit ose kujdestares dhe personin nen kujdestari. Peverc gjinise ne vije te drejte, ku futete edhe prindi edhe femija natyror, ne radhen



e subjekteve qe parashikon dispozita perfshihen edhe prinderit adoptees dhe femijet e adoptuar, et cilet nuk kane lidhje gjaku mes tyre. Ndonese dispozita nuk shprehet, kuptohet se behet fjale per persona qe kane arritur moshen 14 vjec dhe pjekurine seksuale. Kjo veper penale kryehet me dashje, e cila konsiston ne vullnetin e lire dhe pelqimin per te patur maredhenie seksuale me personat e specifikuar ne dispozite, porse kjo deshire duhet te shoqerohet me dijenine per ekzistencen e lidhjes se gjakut ose te aferseise qe percakton dispozita me personin tjeter.



Neni 108

Vepra te turpshme

Kryerja e veperave te turpshme me persona qe nuk kane arritur moshen 14 vjec, denohet me burgim gjer ne pese vjet.

Kjo veper penale ka per object maredheniet juridike te vendosura per te siguruar lirine e zhvillimit mendor te te miturve djem e vajza qe nuk kane arritur moshen 14 vjec. Me vepra te turpshme do te kujtojme te gjithë ato veprime qe synojne te kenaqin epshin seksual te subjektit. Par, nuk

kemi te bejme me bashkim seksual, por vetem veprime qe kane si qellim te kenaqin epshin seksual ne cdo forme tjeter te ndryshme nga bashkimi seksual.

Deshmia e te miturit ne proceset gjyqesore me objekt keto vepra penale

Ne Kodin Penal (sikuresë jane permendur me siper) jane dy dispozita qe marrin ne mbrojtje te drejtperdrejte urine dhe zhvillimin seksual te te miturve qe nuk kane arritur moshen 14 vjec: eshte neni 100, i cili parashikon maredheniet seksuale me te mitur, dhe neni 108, cili parashikon veprat e turpshme. Keto te fundit jane rasti me tipik i shfagjes se abuzimit seksual me te mitur, veçanerisht te moshes parashkollore. Pervoja ka treguar se keta te mitur bien viktime e abuzimit seksual te prindit, kujdestarit, nje te afermi apo dhe te personave te tjere. Ne pjesen me te madhe te rasteve, te miturit jane deshmitaret e vetem te fakteve. Kjo gje dhe veçanerisht moshë e te miturit bejne qe deshmia e tij si prove te kete nje karakter

mjaft delikat. Kjo është arsyeja për të cilën deshmi dhe të miturve, në rastet e abuzimit seksual me ta, është bërë objekt trajtimi për mjaft juriste e psikologe.

Si fillim, le të përmendim disa nga problemet kryesore që prezanton mosha e të miturve në drejtim të deshmisë së tyre në një proces të caktuar. Fëmijet e vegjël nuk e kanë fituar ende skemën konvencionale që i paraprin rievokimit të ngjarjeve të kaluara dhe, për këtë arsye, gjithçka varet nga pyetjet nepermjet të cilave të rriturit drejtojnë kujtimet e tyre. Kërkimet psikologjike të dhjetë viteve të fundit kanë treguar se fëmijet, edhe shumë të vegjël, janë në përputhje të afërta të ofrojnë përmbledhje të dobishme të ngjarjeve, me kusht që të intervistohen në mënyrë të pershtatshme. Duhet mbajtur parasysh se mjaft simptoma, që zakonisht i atribuohen abuzimit seksual, mund të mos jenë specifike, në kuptimin që mund të jenë shkaktuar nga ngjarje të tjera stresuese gjatë jetës së fëmijës, si, p.sh., shpërberja e familjes si rezultat i divorcimit të prindërve. Madje, studimet tregojnë se të ashtuquajturit tregues të

abuzimit seksual mund të takohen edhe tek fëmijë jo të abuzuar.

Burimet e gabimeve në vlerësimin e thëniesve të të miturve, kur dyshohet se me të është abuzuar seksualisht, janë sugjestionimi dhe gjënjeshtrat e vetë fëmijëve. Nëse kjo e fundit është e kuptueshme, sugjestionimi mund të çojë në një interpretim të gabuar të ngjarjeve që nuk përbejnë abuzim seksual, por që ngatërrohen me të. Fëmijet sugjestionohen shumë lehtë, veçanërisht kur janë të vegjël, kur pyeten në distancë të largëta kohë, kur ndjehen të ndrojtur për të rriturit, kur pyetjet janë të keq-



formuluara ose kur sugjestionimi ushtrohet nga nje person i rendesishem nga pikepamja afektive apo nga nje person te cilit femija deshiron t'i konformohet. Per femijen, perceptimi i kohes eshte shume i ndryshem nga ai i te rriturve. Keshtu, nje jave apo nje muaj mund te jete per femijen nje kohe shume me e gjate se per te rriturin. Faktor tjetër që ndikon në sugjestionimin e femijes është gjendja stresit emocional dhe tensionit, menyra se si pyeten dhe personaliteti i atij që pyet.

Keshtu bazuar në rendesine dhe specifikën e veprave të tilla dhe në rolin e vecante të të miturit në proces në cilësinë e deshmëtarit, diktrina njih si procedura standarte:

- Femijet duhet të intervistohen në kohën më të shkurtër të mundshme pasi janë njoftuar autoritete.
- Intervistuesit nuk duhet të perceptohen nga femijet si figura autoritare që kanë pushtetin për të besuar apo jo fjalët e tyre.
- Permbajtja e intervistës duhet të jetë neutrale
- Intervista duhet të përqendrohet mbi ngjarjen në mënyrë të shtruar dhe miqësore etj.



Anisa Metalla
Avokate/Keshilltare Paraligjore,
TLAS

Histori e Vërtetë

Rasti i klientit H. K.

Klienti H.K u paraqit në zyrën e KLAS për t'u këshilluar lidhur me problemin e tij. Ai i përkiste komunitetit Rom dhe prej shumë vitesh jetonte dhe punonte si emigrant në shtetin Grek.

H.K ishte gjyshi biologjik i dy fëmijëve të mitur të moshës tetë dhe gjashtë vjeç. Këta fëmijë kishin ardhur në jetë nga martesë ligjore e djalit të klientit H.K dhe bashkëshortes së tij. Ata të gjithë së bashku jetonin prej vitesh në shtetin Grek ku punonin dhe jetonin, por të papajisur me dokumenta të rregullta qëndrimi.

Si pasojë e një aksidenti djali i klientit H.K humb jetën, duke lënë pas bashkëshorten dhe dy fëmijë të mitur. Pas kësaj ngjarje rrethanat familjare ndryshojnë ndjeshëm. Nëna e fëmijëve, për shkak të një parregullësie me dokumentat detyrohet të kthehet në Shqipëri pa të drejtë kthimi në shtetin Grek për një periudhë pesë vjeçare.

Ajo i lë fëmijët në Greqi për të jetuar me gjyshërit, pra klientin H.K dhe bashkëshorten e tij.

Me kalimin e kohës dhe me rritjen e fëmijëve njëkohësisht filluan të rriten e edhe nevojat e tyre dhe domosdoshmëria për të patur një kujdestar ligjor për t'i përfaqësuar, në kushtet që nëna e tyre e kishte të pamundur të ishte pranë tyre dhe në kushtet që ajo ishte në pamundësi për t'i marrë fëmijët pranë saj.



Kështu për klientin H.K. ishte e nevojshme të hapej një proces gjyqësor ku të kërkonte kujdestarinë ligjore për fëmijët e mitur në kushtet që babai i tyre kishte vdekur dhe nëna ishte në pamundësi për ta ushtruar përgjegjësinë e saj prindërore.

Duke parë rrethanat e çështjes u konstatua që në këtë rast interesi më i lartë i fëmijëve ishte që të kalonin në kujdestarinë ligjore të gjyshit të tyre, klientit H.K. Fëmijët e mitur kishin lindur në shtetin Grek dhe ishin të njohur me ambientin familjar dhe socia al atje, ata shkonin në shkollë dhe në kopësht,

flisnin gjuhën greke dhe memnin edhe pension nga shteti Grek. Për këto arsye edhe nëna e fëmijëve ishte dakort që ishte në interesin më të lartë të fëmijëve të vazhdonin të jetonin në shtetin Grek, duke patur si kujdestar ligjor gjyshin e tyre, deri në kohën që ajo do të bëhëj e aftë ta ushtronte vetë përgjegjësinë prindërore.

Në këto kushte kishte vend të hapej procesi gjyqësor. Duke qënë se klienti H.K nuk kishte mundësi ekonomike ta përballonte një proces të tillë gjyqësor në shtetin Grek ku ishte dhe vendbanimi i fëmijëve, u vendos që procedura gjyqësore të zhvillohej në Shqipëri, në vendbanimin e kërkuarit, klientit H.K dhe të nënës së fëmijës.

Pas hapjes së çështjes në gjykatë, ishte e rëndësishme që të provonim me prova shkresore pretendimet tona, pra: *“që për këta fëmijë që prej lindjes ishin kujdesur bashkarisht gjyshërit dhe prindërit. Pas vdekjes së babait bashkëjetesa e fëmijëve më nënën e tyre është komplikuar, pasi kjo e fundit*



e ka patur dhe vazhdon ta ketë të pamundur të shkelë në territorin e shtetit Grek dhe si pasojë të jetojë me fëmijët. Fëmijët që prej lindjes kishin jetuar në shtetin Grek, ku dhe vazhdonin shkollën dhe aktivitetet e moshës së tyre. Aktualisht nëna biologjike e fëmijëve ishte në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se për arsye të cilat nuk vareshin prej saj ajo nuk jetonte dot pranë fëmijëve të saj dhe gjithashtu nuk i kishte mundësitë ekonomike që të mbante fëmijët pranë saj.

Kjo situatë i jepte mundësi pales kerkuese të perkujdesej si person i afert ne cilësinë e një kujdestari “de facto” për nevojat baze të të miturve, por mungesa e një statusi ligjor të kesaj situatë e pengonte atë që të realizonte ne menyre te plote te drejtat e tij në raport me institucionet shtetërore apo me të tretët në emër të fëmijëve”.

U dëshën disa kohë deri sa të siguroheshin dokumentat e duhuar për procesin gjyqësor, pjesa më e madhe e të cilave duhet të



mereshin në shtetin Grek sipas formës së kërkuar nga ligji.

Gjithashtu situata faktike u argumentua ne gjykate duke u bazuar ne keto parashikime ligjore:

Neni 2 i Kodit të Familjes parashikon se: “Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, ne vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsiderate parësore interesin me te larte te fëmijës”.

Neni 5 i K. të Familjes sanksionon se: “Çdo fëmijë, për një zhvillim të plote dhe harmonik të personalitetit, ka te drejte te rritet ne një



mjedis familjar, ne një atmosfere gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi”.

Neni 224 i K. te Familjes parashikohet se: “Ne qofte se prindërit e fëmijës kane vdekur, janë ne pamundësi te ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, fëmija mund t’i besohet një anëtari te familjes, një personi te caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni te përkujdesjes.

Ne këtë rast merret mendimi i sektorit te ndihmës dhe shërbimeve sociale, sipas dispozitave për kujdestarinë”.

Neni 227: “Përgjegjësia prindërore ndaj fëmijës se lindur jashtë martese.

Përgjegjësia prindërore ndaj fëmijës se lindur jashtë martese ushtrohet nga prindi qe e ka njohur fëmijën si te tij. Ne qofte se ai është njohur nga te dy prindërit, përgjegjësinë prindërore e kane te dy prindërit...”

Neni 267 i K. Familjes sanksionon se: “Ne rast se nuk është caktuar kujdestar nga prindi qe ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, gjykata i jep prioritet zgjedhjes se kujdestarit midis paraardhësve, personave te afërt te te miturit....”

Neni 263: “Vendosja e kujdestarisë

Fëmijët e mitur vendosen ne kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje te veçante nga shteti kur prindërit e tyre janë ne pamundësi për te ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se te dy prindërit kane vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si te pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për te vepru-

ar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.

Gjykate kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit”.

Neni 269: *“Kujdestaria mbi disa të mitur*

Për të miturit që janë vëllezër e motra caktohet një kujdestar i vetëm, përveç rastit kur rrethanat e veçanta kërkojnë domosdoshmërinë e caktimit të me shume se një kujdestari”

Pasi u administruan të gjitha provat shkresore ishte e nevojshme të bëhej edhe një akt ekspertimi psikologjik dhe një tjetër akt vlerësimi i kushteve sociale të nënës, e cila jetonte në Shqipëri. Për këto arsye u thirrën në gjykim një eksperte psikologe dhe një punonjëse sociale nga sektori i ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë Bashkisë Tiranë.

Ato vlerësuan që ishte në interesin më të lartë të fëmijëve të vendoseshin nën kujdesatrinë e gjyshit të

tyre, duke sugjeruar gjetjen e cdo forme dhe menyre për të ruajtur marrëdhënien afektive mes nënës biologjike dhe fëmijëve.

Në këto kushte gjykata e pranoi kërkesën duke i vënë fëmijët e mitur nën kujdesatrinë e klientit H.K.

Anisa Metalla
Avokate/Keshilltare Paraligjore,
TLAS



STREET LAW TE ZHVILLUAR PER VITIN 2012

Projekti	RRETHET							Nr.total i publikimeve	Nr.total i perfitueseve
	Tirane	Durres	Elbasan	Fier	Shkoder	Korce	Vlore		
UNICEF 2011-2012	25.01.2012 24.02.2012							200 Publikime	300 Perfitues
UNDP	29.02.2012	17.02.2012	02.03.2012 10.05.2012					970 Publikime	1200 Perfitues
CRD	03.05.2012 03.06.2012 26.06.2012	06.12.2012	10.04.2012 21.05.2012	10.05.2012 05.07.2012 26.09.2012 02.10.2012				1610 Publikime	1800 Perfitues
UNICEF 2012-2013	12.09.2012 20.09.2012 21.12.2012	14.09.2012 13.11.2012 18.12.2012	28.06.2012 05.10.2012					100 Publikime	200 Perfitues
VAF	14.02.2012 20.02.2012							200 Publikime	300 Perfitues

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 3 / 2012

TLAS

